



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “EQREM ÇABEJ”
SENATI AKADEMIK

Nr. 530 Prot.

Gjirokastër, më 15 / 05 / 2020

**RREGULLORE PËR MASAT HIGJENO -
SANITARE, ORGANIZATIVE DHE
ADMINISTRATIVE
MBI
MINIMIZIMIN E RISKUT NGA COVID - 19
NË INSTITUCIONIN ARSIMOR
UNIVERSITETI “EQREM ÇABEJ” GJIROKASTËR**



Përbajtja

Hyrje

Hyrja dhe dalja nga ambientet e universitetit

Qëndrimi dhe zhvillimi i mësimit në klasa dhe auditoret e përcaktuara

Lëvizjet në mjediset e brendshme të institucionit

Dezinfektimi dhe higjena.....

Hartimi i planit për zhvillimin e procesit mësimor në auditor.....

PROTOKOLLI I MASAVE HIGJENO SANITARE , ORGANIZATIVE DHE ADMINISTRATIVE
GJATË RIKTHIMIT NË AUDITORET E UNIVERSITETIT “EQREM ÇABEJ” PËR
STUDENTËT E VITEVE TË TRETA NË CIKLIN E PARË “BACHELOR”, VITEVE TË DYTA
NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE “MASTER ” DHE “MASTER PROFESIONAL” DHE
VITEVE TË DYTA NË PROGRAMET PROFESIONALE 2- VJEÇARE,

Kjo rregullore e rendshme për masat higjeno sanitare, organizative dhe administrative është hartuar në zbatim të urdhërit nr. 104, datë 30. 04. 2020 për “Marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020 nga Institucionet e Arsimit të Lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia COVID – 19 ” të MASR-së , urdhërit nr. 105 , datë 24 .02.2020 “Për marrjen e mave higjeno sanitare për parandalimin e përhapjes së infeksioneve respiratore akute përfshirë edhe COVID-19 në institucionet arsimore” të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, udhëzuesin e ISHP-së “Për masat ndaj COVID-19, që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore” dhe vendimit të Rektoratit nr. 06, datë 07.05.2020 dhe vendimit të Senatit Akademik nr. 19 , datë, 15.05.2020 “Miratimi i rregullores per masat higjeno –sanitare, organizative dhe administrative mbi minimizimin e riskut nga Covid -19 dhe miratimi i struktura te zhvillimit te procesit mesimor në periudhën Qershori – Tetori 2020 ”, ku krahas zhvillimit të mësimit online do të bëhet dhe rikthimi në auditorët e universitetit “Eqrem Çabej” , të studentëve për vitet e III në programet e ciklit të parë “ Bachelor ”, studentët e viteve të II në ciklin e dyte “Master Profesional ” dhe “Master” dhe studentët e viteve të dyta në programet profesionale.

Kjo rregullore e rendshme e IAL-së është e përkohëshme me veprim gjatë fazës dinamike të pandemisë COVID – 19. Universiteti “Eqrem Çabej ”, në kushtet e pandemisë nga COVID 19, ka qenë i detyruar të kufizojë disa aktivitete arsimore dhe të adaptojë proceset akademike duke zhvilluar mësimin në distancë përmes platformave të ndryshme që e ofrojnë këtë shërbim.

Ndërkohë, mbyllja me sukses e vitit akademik kërkon realizimin brenda verës së vitit 2020, veçanërisht për studentët që diplomohen, të disa proceseve mësimore (leksione, seminare, praktika, laboratore, provime dhe diplomime) për të cilat është e domosdoshme që të sigurohet kryerja e tyre në kushtet e sigurisë shëndetësore për studentet dhe personelin e Universitetit.

Plani i masave të minimizimit të riskut kundrejt COVID-19, për Universitetin “Eqrem Çabej” është në linjë me planin kombëtar të qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe do të adaptohet në dinamikë, në varësi të fazave të pandemisë dhe njohurive shkencore mbi infeksionin.

Objktivi i masave të përfshira në këtë rregullore është të minimizojnë riskun për infektimin nga COVID-19, përmes praktikave të distancimit fizik dhe dezinfektimit. Për të gjitha rastet kur është e domosdoshme të

kryhet aktiviteti akademik me prani fizike të studentëve, duhen zbatuar protokollet dhe masat përfshihen në këtë rregullore.

Rikthimi i studentëve të cilët janë në prag diplomimi do të bëhet në masa të repta duke ndjekur të gjitha protokollet e hartuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të parashikuara në këtë rregullore .

Ndërkoftë, në universitetin “Eqrem Çabej ” vazhdon procesi mësimor online, i filluar në datën 24.03.2020, në të cilin janë përfshirë të gjitha programet dhe ciklet e studimit. Aktualisht jemi në javën e 8 (tetë) të zhvillimit të mësimit në distancë. Përqindja e pjesëmarrjes në klasat virtuale nga ana e studentëve varjon nga 65 % deri në 80 % në rang universiteti. Përditësimet e zhvillimit të mësimit në distancë janë dërguar pranë MASR-së në mënyrë periodike (çdo javë).

Hyrja dhe dalja nga ambientet e universitetit :

1. Orari për hyrjen në ambientet e universitetit “ Eqrem Çabej ” do të jetë sipas një grafiku të miratuar nga njësitë kryesore. Për studentët e programeve “ Bachelor“ dhe studentët e vitit të dytë të programeve me karakter profesional, hyrja për në institucion do të jetë ora 08.00, ndërsa për studentët e programeve të ciklit të dytë “Master ” , “Master Profesional” do të jetë në orën 10.00 . Ky grafik orari do të jetë në varësi të fashave orare që do të shpallen nga Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale dhe në varësi të fazave të zhvillimit të epidemisë.
2. Studentët , stafi akademik dhe administrativ do të paraqiten në institucionin arsimor duke respektuar me përpikmëri orarin e komunikuar dhe të shpallur nga institucioni. Hyrja e të gjithë studentëve, stafit akademik dhe administrativ do të bëhen nga hyrja kryesore e ambienteve të jashtme të universitetit, duke eleminuar dy hyrjet anësore. Të gjithë do të hyjnë me rradhë një e nga një me largësi 1.5 deri në 2 metra.
3. Para hyrjes të të gjithë studentëve dhe stafit akademik, në ambientet e brendshme të përcaktuara në të tre godinat e universitetit, do të kryhet nga ana e **NJVKS**-së në bashkëpunim me personelin administrativ të UGJ-së :
 - a. verifikimi i temperaturës
 - b. verifikimi i pajisjes me maskë dhe doreza personale
 - c. Sprucimin me alkoll 60 % ose dezifikantë të tjera në duar
 - d. Identifikimi i çdo personi në bazë të listave të studentëve, personelit akademik apo stafit administrativ me qëllimin për të mos lejuar që në ambientet e UGJ-së të hyjnë persona të jashtëm.

Studentët me shenja të sëmundjes ose simptoma të ngjashme apo temperaturë këshillohen të qëndrojnë në shtëpi dhe të informojnë sekretarinë mësimore përmes telefonit. Sekretaria mësimore informon në dekanat për çdo rast të evidentuar.

Të gjithë studentët që do të rikthehen në auditore , do të informohen për godinën, katin dhe klasën ku do të zhvillojnë mësimin. Ata nuk do të lëjohen të lëvizin nëpër korridoret e institucionit dhe gjithashtu nqse dalin nga godina për një arsyе çfarëdo nuk do të rikthehen përsëri në të brenda ditës.



Tre godinat e universitetit “Eqrem Çabej ” Gjirokastër, në infrastrukturën e tyre kanë një derë hyrëse dhe një derë dalëse. Secila prej tyre do të ketë sinjalistikën e duhur ku do të jetë e përcaktuar hyrja dhe dalja e të gjithë studentëve, pedagogëve dhe stafit administrativ.

Të gjitha godinat e institucionit do të kenë të afishuar të gjithë sinjalistikën e duhur horizontale dhe vertikale për mbajtjen e distancës (1.5 deri në 2 metra). Dalja nga klasat apo nga godinat për të gjithë studentët do të bëhet nën mbykqyrjen e personelit akademik dhe punonjësve që janë përcaktuar për kryerjen e kësaj detyre nga ana e Administratorit të UGj-së.

Studentët dhe stafi që nuk do të zbatojnë këtë rregullore, do të ndëshkohen me masa disiplinore.

Qëndrimi dhe mësimi në klasa dhe auditoret e përcaktuara nga njësitë kryesore

1. Gjatë zhvillimit të procesit mësimor në klasat e përcaktuara sipas orarit nga njësitë bazë do të respektohet me përpikmëri distanca prej 1.5 - 2 metra nga një student te tjetri. Në bazë të hapësirës së çdo ambienti në m^2 , do të bëhet prarashikimi i numurit të studentëve duke ndjekur protokollet e distancimit fizik.
2. Personeli akademik do të qëndrojë në klasë duke respektuar distancimin me studentët 1.5 - 2 metra.
3. Brenda klasës, studentët do të qëndrojnë të ulur në banka në distancë nga njëri tjeter, atje ku grupei mësimor ka më shumë studentë se hapësira e lejuar, grupei mësimor do të ndahet në klasa të tjera.
4. Studentët gjatë zhvillimit të mësimit do të jenë të pajisur të gjithë me maskë dhe dorashka. Lektori para fillimit të mësimit do të sigurohet që të gjithë janë të paisur me masa mbrojtëse.
5. Nuk do të lejohet lëvizja e studentëve gjatë ditës nga një klasë në një klasë tjetër. Grupi/nëngrupi mësimor do të zhvillojë të gjitha orët e mësimit në klasën e përcaktuar.

Lëvizjet në mjediset e brendshme të institucionit

1. Lëvizja e studentëve në klasa/ laboratorë do të bëhet e përcaktuar në bazë të sinjalistikës së vendosur në të gjitha ambientet e brendshme të univiersitetit.

2. Studentët që do të jenë në klasat e përcaktuara do të përdorin vetëm tualetin në korridorin ku ndodhet klasa apo salla e tyre pa u takuar në asnjë moment me studentët e klasave të tjera.
3. Nuk do të lejohet për asnjë arsy qëndrimet apo grumbullimet nëpër korridoret e universitetit.
4. Studentët, në kohën e lëvizjes së detyruar në koridore për hyrjet dhe daljet nga klasat, gjatë fillimit apo fundit të procesit mësimor ditor, do të respektojnë gjithmonë largësinë 1.5-2 metra nga njëri tjetri.
5. Komunikimi në raste të domosdoshme të studentëve me drejtuesit, sektaritë mësimore apo dhe stafin mësimor do të kryhet nëpërmjet personit/personave përgjegjës të caktuar nga institucioni në zbatim të kësaj rregulloreje, gjithmonë në respektim të distancimit.
6. Në klasa gjatë zhvillimit të orës së mësimit nuk lejohet të shpërndahen materiale të printuara. Bëjnë përjashtim materiale mësimore personale (tekste, cikël leksionesh etj.) që disponojnë studentët.
7. Ndalohet përdorimi i sendeve personale të panevojshme për procesin mësimor.

Dezinfektimi dhe higjena

1. Do të ketë komunikim të vazhdueshëm rreth masave për sigurimin e higjenës personale si dhe të ambienteve në universitetin “Eqrem Çabej”.
2. Çdo student, staf akademik apo administrativ duhet të lajë duart pas çdo veprimi që mund të përbëjë rrezik për përhapjen e virusit. Të shmangen prekja e hundës, syve, gojës etj.
3. Në ambientet e institucionit, përkatesisht në hyrjet e godinave të njësive kryesore, do të vendosen dezifikantë me përbajtje alkoli 60% për dezifikimin e duarve para hyrjes në ambiente. Ndërsa në ambientet e brendshme, veçanërisht tualetet, do të sigurohet ujë i rrjedhshëm, sapun i lëngshëm, letra përfshirjen e duarve.
4. Gjatë qëndrimit në ambientet e institucionit tonë çdo student /personel akademik/personel administrativ do të duhet të mbajë detyrimisht maskë dhe dorashka.
5. Në ambientet ku do të zhvillohet procesi mësimor do të kryhet ajrosja nëpërmjet ditareve rreth 5 – 6 herë gjatë kohës që do të zhvillohet mësim.
6. Personeli dhe studentet dezinfektojnë duart edhe gjatë hyrjes/daljes duke përdorur kontenierët e vendosur për këtë qëllim në katin përkatës.
7. Në të gjitha ambientet e universitetit do të afishohen postera mbi masat e parandalimit të infeksionit COVID – 19: për mënyrën e përhapjes së këtij virusi apo postera për mënyrën e larjes së duarve.
8. Siperfaqet e tavolinave në auditore do të dezinfektohen nga personeli sanitari pas çdo aktiviteti arsimor duke përdorur pajisjet e vendosura në auditorë për këtë qëllim.

9. Korridoret e mjediseve ku zhvillohet aktiviteti arsimor pastrohen/dezinfektohen çdo dy orë. Tualetet pastrohen/dezinfektohen çdo 30 minuta. Dorezat, parmakët dhe siperfaqe të tjera në mjediset pranë sallës/audititorit ku zhvillohet aktiviteti arsimor, pastrohen/dezinfektohen çdo 30 minuta.

10. Çdo ditë pas përfundimit të procesit mësimor do të kryhet pastrimi i të gjithë sipërsaqeve në klasa dhe orendive në to me lëndë dezifikuese si dhe dezifikimi i mjediseve të përbashkëta të institucionit.

11. Përpara se të rifillojë mësimi në auditoret e universitetit sipas kësaj rregulloreje për parandalimin e përhapjes së COVID-19, studentët, stafi akademik dhe stafi administrativ duhet të plotësojë një Formular Vetëdeklarimi për situatën e tyre shëndetësore si dhe të familjarëve të tyre, si kusht për të hetuar paraprakisht mundësinë e ndonjë vatre infeksioni të COVID-19.



Hartimi i planit për zhvillimin e procesit mësimor në auditore

Për marrjen e masave organizative dhe administrative, Administratori i UGj-së dhe njësitë kryesore ngrenë grupe pune me qëllim menaxhimin e situatës për zhvillimin e procesit mësimore në auditore (leksione, seminare, punë laboratorike, praktika profesionale, provime, mbrojtje diplome etj.) në kushte të standartizuara të distancimit fizik dhe ato higjeno-santare të përcaktuara në këtë rregullore.

Njësitë bazë dhe njësitë kryesore në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID-19, ritractuan çështjen e strukturës së zhvillimit të procesit mësimor, i cili, prej vendosjes së gjëndjes së fatkeqësisë natyrore është zhvilluar në distancë përmes platformave on-line të miratuara nga njësitë bazë. Struktura e ripunuar e zhvillimit të procesit mësimor për semestrin e dytë sipas programeve të studimit (bachelor, master apo programe profesionale) do të jetë sipas këtyre modeleve:

Struktura mësimore për programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor"

| Nr | Emërtimi | SEMESTRI II | | |
|----|-----------------------|--|---------|--------------------|
| | | Viti I | Javë | Forma e zhvillimit |
| 1. | Mësim | 24.02.2020 - 06.03.2020 23.03.2020 - 19.06.2020 | 2 13 | auditor online |
| 2. | Përsëritje mësimi | 24.08.2020 - 11.09.2020 | 3 | auditor |
| 3. | Praktika profesionale | 01.06.2020 - 12.06.2020 | 2 | auditor/terren |
| 4. | Provime | 14.09.2020 - 25.09.2020 | 2 | auditor |
| 5 | Provime (vjeshtë) | 12.10.2020 - 30.10.2020 | 3 | auditor |

| Nr | Emërtimi | SEMESTRI II | | |
|----|-----------------------|--|---------|--------------------|
| | | Viti II | Javë | Forma e zhvillimit |
| 1. | Mësim | 24.02.2020 – 06.03.2020 23.03.2020-19.06.2020 | 2 13 | auditor online |
| 3. | Praktikë profesionale | 01.06.2020 - 12.06.2020 | 2 | auditor/terren |
| 4. | Përsëritje mësimi | 24.08.2020 - 11.09.2020 | 3 | auditor |
| 4. | Provime | 14.09.2020 - 25.09.2020 | 2 | auditor |
| 5. | Provime (vjeshtë) | 12.10.2020-30.10.2020 | 3 | Auditor |

| Nr | Emërtimi | SEMESTRI II | | |
|----|-----------------------|--|---------|--------------------------|
| | | Viti III | Javë | Forma e zhvillimit |
| 1. | Mësim | 24.02.2020 – 06.03.2020 23.03.2020-19.06.2020 | 2 13 | auditor online |
| 3. | Praktikë profesionale | 02.03.2020 - 09.03.2020 22.06.2020 - 17.07.2020 | 1 4 | spital online/auditor |
| 4. | Përsëritje mësimi | 01.06.2020 - 19.06.2020 | 3 | auditor |
| 4. | Provime | 22.06.2020 - 17.07.2020 | 4 | auditor |
| 5. | Diploma | 27.07.2020 - 07.08.2020 | 2 | auditor |

Struktura mësimore për programet e studimit te ciklit të dytë, Master Profesional

| Nr | Emërtimi | SEMESTRI II | | |
|----|-------------------|-----------------------|------|--------------------|
| | | Viti I | Javë | Forma e zhvillimit |
| 1. | Mësim | 23.03.2020-03.07.2020 | 15 | online |
| 2. | Përsëritje mësimi | 24.08.2020-18.09.202 | 4 | auditor |
| 3. | Provime | 21.09.2020-02.10.2020 | 2 | auditor |
| 4. | Provime (vjeshtë) | 05.10.2020-23.10.2020 | 3 | auditor |

| Nr | Emërtimi | SEMESTRI II | | |
|----|--------------------------|-----------------------|------|------------------------|
| | | Viti II | Javë | Forma e zhvillimit |
| 1. | Mësim | 02.03.2020-06.03.2020 | 1 | auditor |
| | | 23.03.2020-30.04.2020 | 6 | online |
| 3. | Praktikë profesionale | 04.05.2020-29.05.2020 | 4 | online |
| | | 01.06.2020-12.06.2020 | 2 | auditor/terren/bisnese |
| 4. | Persëritje mësimi | 15.06.2020-26.06.2020 | 2 | auditor |
| 5. | Provime | 29.06.2020-24.07.2020 | 4 | auditor |
| 6. | Provim formimi | 27.07.2020-07.08.2020 | 2 | auditor |
| 7. | Provime (vjeshtë) | 05.10.2020-23.10.2020 | 3 | auditor |
| | Provim formimi (vjeshtë) | 26.10.2020-30.10.2020 | 1 | auditor |

A. Struktura mësimore për programet profesionale

| Nr | Emërtimi | SEMESTRI II | | |
|----|-------------------|-----------------------|------|--------------------|
| | | Viti I | Javë | Forma e zhvillimit |
| 1. | Mësim | 02.03.2020-12.06.2020 | 15 | online |
| 2. | Përsëritje mësimi | 25.08.2020-25.09.2020 | 4 | auditor |
| 3. | Provime | 28.09.2020-02.10.2020 | 2 | auditor |
| 4. | Provime (vjeshtë) | 05.10.2020-23.10.2020 | 4 | auditor |

| Nr | Emërtimi | SEMESTRI II | | |
|----|-----------------------|-------------------------|------|------------------------|
| | | Viti II | Javë | Forma e zhvillimit |
| 1. | Praktikë profesionale | 02.03.2020 – 06.03.2020 | 1 | Terren/intitucione |
| | | 04.05.2020-29.05.2020 | 4 | online |
| | | 01.06.2020-07.08.2020 | 10 | auditor/terren/bisnese |
| 2. | Provime (vjeshtë) | 05.10.2020-23.10.2020 | 3 | auditor |

Në zbatim të kësaj strukture të zhvillimit të procesit mësimor dhe në zbatim të sandarteve të distancimit fizik dhe atyre higjeno-sanitare e disifektuese, njësitë bazë kanë hartuar grafikun e zhvillimit të të gjitha proceseve mësimore (leksione, seminare, punë laboratorike, praktika profesionale, provime, mbrojtje diplome etj.) sipas këtij modeli:

| Nr | Lënda/moduli | Nr klasës | Sip e klasës | Nr. studentëve |
|----|-----------------------|-----------|-------------------|----------------|
| 1 | Leksion /Seminar | 206 B | 39 m ² | 7 |
| 2 | Praktikë profesionale | 401 A | 42 m ² | 8 |
| 3 | Laborator | 205 B | 60 m ² | 9 |
| .. | | | | |

Administratori i UGj-së dhe Sektori i Standartave dhe Kurrikulave në Universitetin “Eqrem Çabej” përcaktuan numurin e përgjithshëm të ambienteve për zhvillimin e të gjitha proceseve mësimore (leksione, seminare, punë laboratorike, praktika profesionale, provime, mbrojtje diplome etj.), sipërfaqet përkatëse për secilin ambient mësimor, numrin e studentëve që duhet të vendosen në secilin ambient mësimor si në vijim:

Kapacitetet mësimore të Universitetit “Eqrem Çabej”

| GODINA A | | | | GODINA B | | | |
|----------|----------------------|------------------------------|-----------------|----------|----------------------------------|---------------------------------|------------------|
| Nr | Emërtimi i ambientit | Sipërfaqja në m ² | Nr i studentëve | Nr | Emërtimi i ambientit | Sipërfaqja në m ² | Nr i studenteve. |
| 1 | 101 A | 60 | 15 | 1 | 101 B | 38 | 9 |
| 2 | 103 A | 45 | 9 | 2 | 102 B | 60 | 9 |
| 3 | 201 A | 50 | 12 | 3 | 103 B | 44 | 14 |
| 4 | 202 A | 38 | 9 | 4 | 104 B | 41 | 6 |
| 5 | 203 A | 52 | 12 | 5 | 201 B | 38 | 8 |
| 6 | 301 A | 42 | 6 | 6 | 202 B | 57 | 9 |
| 7 | 302 A | 42 | 9 | 7 | 203 B | 60 | 14 |
| 8 | 303 A | 42 | 9 | 8 | 204B | 44 | 9 |
| 9 | 304 A | 45 | 6 | 9 | 205 B | 60 | 9 |
| 10 | 305 A | 48 | 5 | 10 | 206 B | 39 | 9 |
| 11 | 306 A | 53 | 5 | 11 | 207 B | 60 | 8 |
| 12 | 307 A | 35 | 5 | 12 | 301 B | 38 | 9 |
| 13 | 308 A | 35 | 5 | 13 | 302 B | 57 | 9 |
| 14 | 310 A | 57 | 8 | 14 | 303 B | 60 | 14 |
| 15 | 311 A | 24 | 3 | 15 | 305 B | 80 | 12 |
| 16 | 312 A | 55 | 5 | 16 | 401 B | 38 | 15 |
| 17 | 313 A | 52 | 6 | 17 | 402 B | 40 | 5 |
| 18 | 401 A | 42 | 9 | 18 | 403 B | 67 | 11 |
| 19 | 402 A | 42 | 9 | 19 | mediateka | 47 | 20 |
| 20 | 403 A | 42 | 9 | 20 | salla e konf. | 210 | 35 |
| 21 | 404 A | 45 | 7 | 21 | Salla e mesimit Teavet | 42 | 5 |
| 22 | 405A | 70 | 8 | | | | |
| 23 | 406 A | 58 | 8 | | Shuma ambinteve | | 46 |
| 24 | 407A | 54 | 6 | | Kapaciteti | | 432 studentë |
| 25 | 408 A | 41 | 8 | | Studentë në një ditë mësimore | | 300 - 432 |

Kjo rregullore miratohet nga Senati Akademik i Universitetit “Eqrem Cabej” dhe hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF.DR. BEKTASH MEMA

